

AKT NORMATIV
Nr. 27, datë 1.7.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9936, DATË 26.6.2008,
“PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 49, të nenit 3, shtohet pika 50, me këtë përmbajtje:

“50. “Balanca primare buxhetore” është sa të ardhurat totale buxhetore minus shpenzimet totale buxhetore plus shpenzimet për interesa.”.

Neni 2

Në nenin 4/1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit, përveçse në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme që parashikohen në nenin 4/4, të këtij ligji.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Duke filluar që prej vitit buxhetor 2023 e në vijim, balanca primare buxhetore nuk duhet të rezultojë më e vogël sesa zero, përveçse në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme që parashikohen në nenin 4/4, të këtij ligji.”.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama